



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 10-2008
Prishtinë, më 15 prill 2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Kolë Berisha, Riza Smaka, Bajram Kosumi, Džezair Murati.

Munguan: Branisllav Grbiq, Melihate Tërmkolli, Selvije Halimi dhe Adem Hajdaraj.

Të ftuarit: Rifat Abdullahu - Gjykata Komunale, Ferizaj, Ferid Bislimi - Gjykata e Qarkut, Prishtinë, Lumnije Murati - ZPK, Reshit Gashi - NDI, Silke Clausing - OSBE, Ramadan Islami - OSBE, Lejla Selimi - OSBE, Robert Steere - NCSC, Violaine Autheman – USAID, Justice Support Program, Fitore Zeneli - KDI.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Behlul Zeka dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 1 prillit 2008
3. Shqyrtimi i Projektligjit për procedurën përmbareuese dhe i Projektligjit për procedurën jokontestimore
4. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 1 prillit 2008

Kryetari – I pyeti anëtarët nëse kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

Kolë Berisha - Tha se ka vërejtje në procesverbal te pjesa e diskutimit “i përkohshëm”. Nuk kam thënë se nuk pajtohem, andaj të hiqet kjo fjalë.

Procesverbali u miratua me vërejtjen e deputetit Kolë Berisha.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për procedurën përmbareuese dhe i Projektligjit për procedurën jokontestimore

Kryetari - Nënvizoi se raportuesi dhe eksperti për këtë Projektligj i kanë përgatitur sugjerimet dhe propozimet e tyre për ndryshime në këtë Projektligj.

Rifat Abdullahu - Kryetari i Gjykatës Komunale të Ferizajt, në cilësi të ekspertit, i paraqiti sugjerimet dhe propozimet e tij për këtë Projektligj.

Meqë raportuesi nuk ishte i pranishëm për shkak të obligimeve personale, kryetari i Komisionit, Bahri Hyseni, theksoi se ky Projektligj i plotëson kushtet në përgjithësi dhe nuk ka vërejtje që do ta ndryshonin në thelb përmbajtjen e tij.

Silke Clausing (OSBE) - I paraqiti vërejtjet e organizatës që e përfaqëson dhe vuri në pah se përkthimi i Projektligjit në gjuhën angleze nuk kuptohet lehtë.

Robert Steere (NCSC) - U pajtua në lidhje me përkthimin dhe shtoi se pjesa në gjuhën angleze nuk është e kuptueshme dhe se organizata e tij e ka marrë përsipër ta bëjë lekturimin që do t’ia sjellë edhe Komisionit. Ai më tutje shtoi se përkundër lekturimit do të mbeten edhe mjaft çështje të tjera që lidhen me sqarimin e terminologjisë së përdorur në pjesën e tekstit të përkthyer në gjuhën angleze.

Kryetari - I falënderoi parafolësit për kontributin e tyre që po e japin në lidhje me këtë Projektligj.

Pas diskutimit për këtë pikë, Komisioni njëzëri vendosi që raportuesi së bashku me ekspertin dhe stafin mbështetës të Komisionit të punojnë në ditët e ardhshme për t’i përgatitur vërejtjet dhe komentet në letër. Kjo të bëhet sa më parë, sepse para datës 27 prill 2008 duhet të dorëzohen për seancën plenare.

3. Projektligji i procedurës përmbarese

Raportuesi **Ramadan Gashi** - Theksoi se Projektligji i plotëson kriteret dhe standardet.

Ferid Bislimi, gjykatës i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë - Në cilësi të ekspertit i paraqiti sugjerimet dhe propozimet e tij për këtë Projektligj.

Riza Smaka - Propozoi që me një amendament të thuhet se nenet e caktuara, që janë në Projektligjin e procedurës kontestimore, janë të zbatueshme edhe për Projektligjin e procedurës përmbarese.

Bajram Kosumi - Theksoi se kjo mund ta ndërlikojë punën e gjykatësit.

Gjykatësi, **Ferid Bislimi** - Nënvizoi se pasi gjykatësit punojnë me të dy ligjet, atëherë edhe ndërlikimet do të mund të shmangen dhe kjo mund të bëhet përmes një amendamenti.

Kryetari - I paraqiti vërejtjet e tij. Ai i vuri në pah paqartësitë në Projektligj duke filluar nga neni 3, që thotë: “parashihet me ligj”, dhe kërkoi të qartësohet se me cilin ligj parashihet kjo. Në nenin 7, “pasuritë nëntokësore dhe pasuritë e tjera natyrore”, të qartësohet cilat pasuri të tjera natyrore. Në nenin 8 të sqarohet pjesa e dispozitës “me anë të atij mjeti”. Në nenin 12.6 të qartësohet pjesa “kur me titullin ekzekutiv”. Në nenin 20.2 “shërbimet e tyre”, për çfarë shërbimesh bëhet fjalë. Të qartësohet gjithashtu edhe neni 35.2. Në nenin 40, të qartësohet çka do të thotë: “dokumenti i besueshëm”. Duhet të kihet parasysh se ndoshta mund të hiqet neni 53.2. Neni 53.3 gjithashtu të hiqet. Neni 254.3 gjithashtu të qartësohet.

Silke Clausing - Theksoi se pasi që USAID-i ka dhënë komente më të hollësishme, OSBE ka bërë vetëm komente të përgjithësuara. Ajo më tutje i paraqiti komentet e Departamentit të Drejtave të Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete për Projektligjin e procedurës përmbarese. Versioni në gjuhën angleze i Projektligjit kuptohet vështirë.

Riza Smaka - Kërkoi që terminologjia të jetë unike. P.sh. përdorimi i termave: abrogim, ex tunc dhe ex nunc. Gjithashtu të përmendet edhe aktpadia opozicionale dhe opungacionale.

Pas diskutimit për këtë pikë, Komisioni njëzëri vendosi që raportuesi së bashku me ekspertin dhe stafin mbështetës të Komisionit të punojnë gjatë ditëve të ardhshme për t'i përgatitur vërejtjet dhe komentet në letër. Kjo të bëhet sa më parë, sepse para datës 27 prill 2008 duhet të dorëzohen për seancën plenare.

4. Të ndryshme

Kryetari - Theksoi se është kërkuar afat shtesë për Projektligjin për noterinë, pasi që në javën e ardhshme do të vijë edhe eksperti zviceran që ka punuar për hartimin e këtij Projektligji. Ai më tutje shtoi se duke e pasur parasysh se ky është një institucion i ri në Kosovë, atëherë është më mirë të kemi më tepër kohë në dispozicion për ta përgatitur më mirë këtë Projektligj.

Kryetari i falënderoi edhe një herë të pranishmit dhe në orën 12:30 e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Procesverbalin e hartoi:
Behlul Zeka, zyrtar ligjor

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni